



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

## KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR FURNIZIM (ME NJE OPERATOR)

**KOMUNA E ISTOGUT, Njesia e Prokurimit te cilën e përfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z-nja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga “Fadil Ferati” nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, ne cilësinë e porositesit te sherbimeve të Autoritetit Kontraktues në njëren anë;**

**dhe**

**“SHKËMBI” SHPK të cilën e përfaqëson z. Musa Metaj, në cilësinë e menaxherit Zona Industriale ne Istog, me Nr. Unik të Rexhistrimit te biznesit: 810296039 ne vazhdim “Furnizuesi”, ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet si me poshtë:**

### MIRËMBAJTJA E PROJEKTEVE INFRASTRUKTURE

Nr. I prokurimit	633-20-2873-1-2-1/FA064
Nr. I brendshëm	633 / 020 / 034 / 121

#### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

### MIRËMBAJTJA E PROJEKTEVE INFRASTRUKTURE1

**Autoriteti Kontraktues bënë blerjen vetëm në emër të vetë Autoritetit]**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indicative që Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të

detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëra; të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me NËNSHKRIMIN E SAJË PERKATESISHT ME DATË 11.09.2020 DHE DO TË PERFUNDOJË ME SE LARTI DERI ME 12.10.2023 PASI KONTRAKTORI TE DESHMOJE SIGURINË PER EKZEKUTIMIN E KONTRATËS ME VLEFSHMERI PREJ 37 MUAJVE, NGA DATA E NENSHKRITIT TE KONTRATËS.

## **Neni 2 Kushtet e dërgesës**

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjen e të gjitha FURNIZIMEVE – SHERBINMEVE do të jetë: **12.10.2023**.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit dhe shërbimeve tjera do të jenë rrugët NË TERITORIN E KOMUNËS SË ISTOGUT – BAZUAR NE REKOMANDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, RESPEKTIVISHT NJËSISË KËRKUESE..

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

## **Neni 3 Origjina**

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

## **Neni 4 Çmimi**

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi i datës: **14.07.2020**

Vlera e kontratës për periudhën 3.Vjeçare është: **76.010,00 Euro**.

**Dhe me shkronja: /Shtatëdhjetëegjashtëmijëezerodhjetëzerozero/**

4.2 Ky çmim mund të ndryshojë sipas: (Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 38 paragrafi 2, lejon +- 30% e vleres së kontrates) po qe se për këtë paraqitet nevoja nga Autoriteti Kontraktues. Po qe se urdherblerjet kalojnë sasinë totale të kontrates publike kornizë (duke përfshirë + 30%), pa marrë parasysh datën origjinale të nënshkrimit, e njëjta shkeputet automatikisht.

4.3 Çmimi i përmendur për NJËSI në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

---

4.4 [Çmimet per njësi janë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë.

4.5 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

## **Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës**

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

*Plani per menaxhimin e kontrates*

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## **Neni 6 Komunikimet**

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.





6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tijë.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:  
Komunën e Istogut

Për Kontraktuesin:  
Shkëmbi Shpk

<b>Emri:</b> <i>per</i>	Zizë Bujupaj	<b>Emri:</b>	"Shkëmbi" shpk
<b>Pozita:</b>	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit	<b>Pozita:</b>	Musa Metaj <i>M e n a x h e r</i>
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	<i>24.09.2020</i>	<b>Data:</b>	<i>10.09.2020</i>
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

## KOMUNA E ISTOGUT

## Paramasa per projektin "Mirëmbajtja e projekteve infrastrukturore"

	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia	Sasia e përafert	Cmimi/Njesi
	Aktivitetet				
1	Prerja e Asfaltit	m2	1	90	5.00
2	Furnizimi dhe vendosja e Asfaltit-perfshirë te gjitha perkrahjet per nje aktivitet te tillë	m2	1	300	10.00
3	Germimi i dheut me bager per tokë te kategorisë III-IV-të	m3	1	700	1.50
4	Germimi i dheut me dorë per tokë te kategorisë III-IV-të	m3	1	300	3.00
5	Furnizimi dhe kubezimi me kubëza 8cm	m2	1	600	9.0 €
6	Furnizimi dhe kubezimi me kubëza 6cm	m2	1	600	8.0 €
7	Furnizimi dhe vendosja e anësoreve te me dimensione 8x22x100cm	copë	1	600	6.0 €
8	Furnizimi dhe vendosja e anësoreve te me dimensione 18x24x100cm	copë	1	500	8.0 €
9	Furnizimi,planifikimi dhe shtruarja me dhe natyral	m3	1	600	4.0 €
10	Furnizimi,planifikimi dhe shtruarja me dhe te kualitetit te lartë-humus	m3	1	300	10.0 €
11	Furnizimi dhe shtrirja e shoder( Shtrirje dhe ngjeshje)	m3	1	300	8.0 €
12	Furnizimi dhe shtrirja e sterilit( zhavor) shtrirje dhe ngjeshje	m3	1	300	5.0 €
13	Furnizimi dhe shtrirja e zhavorit te fraksionuar 0-62mm	m3	1	300	8.0 €
14	Furnizimi dhe shtrirja me rerë te imet 0-2mm	m3	1	500	10.0 €
15	Furnizimi dhe vendosja e gypit te kanalizimit Ø160mm	m	1	800	2.0 €
16	Furnizimi dhe vendosja e gypit te kanalizimit Ø200mm	m	1	700	3.0 €
17	Furnizimi dhe vendosja e gypit te kanalizimit Ø250mm	m	1	600	3.0 €
18	Furnizimi dhe vendosja e gypit te kanalizimit Ø315mm	m	1	400	7.0 €
19	Furnizimi dhe vendosja e gypit te kanalizimit Ø400mm	m	1	300	2.0 €
20	Furnizimi dhe vendosja e gypit te kanalizimit Ø500mm	m	1	150	3.0 €
21	Furnizimi dhe vendosja e gypit te ujësjellsit Ø1/2	m	1	700	0.8 €
22	Furnizimi dhe vendosja e gypit te ujësjellsit Ø3/4	m	1	700	1.0 €
23	Furnizimi dhe vendosja e gypit te ujësjellsit Ø32	m	1	600	1.5 €
24	Furnizimi dhe vendosja e gypit te ujësjellsit Ø40	m	1	600	1.5 €
25	Furnizimi dhe vendosja e gypit te ujësjellsit Ø50	m	1	600	1.5 €
26	Furnizimi dhe vendosja e gypit te ujësjellsit Ø63	m	1	500	2.5 €
27	Furnizimi dhe vendosja e gypit te ujësjellsit Ø75	m	1	400	1.0 €
28	Furnizimi dhe vendosja e gypit te betonit Ø1000mm	copë	1	150	20.0 €
29	Furnizimi dhe vendosja e konusit te betonit	copë	1	150	15.0 €
30	Furnizimi dhe vendosja e kapakut te betonit	copë	1	150	2.0 €
31	Shpimi horizontal me raketa shpuese	m	1	200	10.0 €
32	Germimi dhe hapja puseve(bunareve)	m	1	150	25.0 €
33	Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave nga hapsirat publike	m3	1	1,000	3.0 €
34	Ujitja e siperfaqeve gjelbruese dhe drunjëve	m2	1	8,000	0.2 €
35	Kositja e barit sipas specifikimit teknik	m2	1	2,500	0.3 €
36	Mirëmbajtja e vijave ujore-projeve ne qytet	m	1	1,000	3.0 €
37	Mbjellja e drunjeve te rinje me trashesi Ø60 dhe gjatesi 3m te llojit Rrap	copë	1	300	5.0 €
<b>TOTALI I NJESIVE ME TE GJITHA NGARKESAT</b>					

<b>Gjithsejt</b>
450.00
3,000.00
1,050.00
900.00
5,400.00
4,800.00
3,600.00
4,000.00
2,400.00
3,000.00
2,400.00
1,500.00
2,400.00
5,000.00
1,600.00
2,100.00
1,800.00
2,800.00
600.00
450.00
560.00
700.00
900.00
900.00
900.00
1,250.00
400.00
3,000.00
2,250.00
300.00
2,000.00
3,750.00
3,000.00
1,600.00
750.00
3,000.00
1,500.00
<b>76,010.0 €</b>